

“Shqipëria dhe shqiptarët në Europën e Piut II”

Nga “Parafjala” e librit të Aurel Plasarit

“Karta europiane e identitetit e shqiptarëve”: edhe kështu mund të titullohej ky libër për nga rëndësia kulturo-historike që paraqet pozicioni i Arbërisë dhe i arbërve në veprën e Enea Silvio Piccolominit, veçan te De Europa e tij, por edhe në pjesën tjetër të saj. Përfshirja në Europën e tij si e pjesës së saj perëndimore, ashtu edhe e asaj lindore, - çfarë e zhdukte tendosjen e dikurshme mes Lindjes dhe Perëndimit si pa baza reale gjeografike, historike, kulturore, - i mundësoi vizionit politik të Piut II t’ua pohonte sa arbërve, aq edhe Arbërisë vendin e tyre në konstruksionin e Europës humaniste. Nga studiuesit e historisë europiane të shqiptarëve kjo situatë pothuajse nuk është vënë re. Ndoshta nuk është kuptuar.

Një nga meritat madhore që i njihet humanistit Enea Silvio ishte që aktualizoi konceptin Europë, të trashëguar nga mitologjia dhe tradita mesjetare, duke e mbushur atë me përmbajtje të re dhe duke përruar vizionin e një Europe si bashkësi gjeografike, historike, kulturore dhe – sidomos – politike, të panjohur si të tillë deri përpara tij. Pozicioni ndërkombëtar në të cilin, në kapërcyellin e Mesjetës së vonshme dhe Kohës së Re, vendoseshin arbërit dhe Arbëria në veprën e një humanisti si Enea Silvio, i cili i dha konceptit Europë përmbajtjen e re nëpërmjet pajtimit të unitetit shpirtëror dhe njëherësh politik të saj, nuk mund mos të tërheqë vëmendje edhe më përtej. Edhe vetëm kreu “Albania”, njëri nga krerët e rëndësishëm të librit De Europa, të detyron të kujtosh që Piu II përshkruante tanimë një vend që në burimet e gjeografisë antike nuk e kishte ndeshur si të tillë, ndonëse kishte shtënë në punë Ptolemeun, Strabonin, Plinin etj.

Europa e tij humaniste konstruktohej në kontingjencat e ballafaqimit të popujve të Europës me ekspandimin e përdhunshëm turko-osman. Në ato kontingjenca qëndresa dhe luftërat e popullsive arbëre, si situatë e re politike europiane, do të tërhiqnin sa vëmendjen, aq edhe interesin e humanistit emërmadh ndaj Arbërisë. Në rrethanat e kërcënimit nga një rrezik i përbashkët për popujt europianë nuk mund të mos i vihet një theks këtij ballafaqimi të arbërve me ekspandimin turk në Kontinent, sepse ai pati ndikimin e vet në ngritjen e potencialit arbër dhe funksionalizimin e tij, brenda qytetërimit përkatës, në Europën e asaj kohe. Në fillim me fitoret e njëmbasnjëshme të turqve, mandej me kulmin në pushtimin e Kostandinopojës prej tyre, ekspandimi në fjalë nuk do të kishte vetëm implikime fetare, sikurse mendohet rëndom. Madje as vetëm implikime politike, siç do të shihet. Kundërvënia ndaj ekspandimit turk në emër të një modeli qytetërimor përbënte një karakteristikë të spikatur të vetë Lëvizjes humaniste në kapërcyell të Kohës së Mesme dhe Kohës së Re përkundrejt “rrezikut të jashtëm”. Është e vërtetë që humanistët do të trashëgonin idenë e vjetër mesjetare të kryqëzatës, por nuk ka dyshim që ajo do të modernizohej prej tyre duke e vendosur

problemin kryqtar në horizontin e një lufte mes qytetërimit dhe barbarisë. Ishte një orvatje për të konverguar në një synim të vetëm traditën e krishterë me diturinë klasike. Ky qe projekti që u mishërua më së miri në veprën e Enea Silvios. Humanistët e valëvisnin flamurin e kryqëzatës kundër Turkut në emër të mbrojtjes së "letrave të bukura", siç i quanin, armiq të cilave paraqiteshin turqit e ardhur nga Azia. Që një kundërvënie e tillë mund të konceptohej në mënyrë të thjeshtuar, ndoshta edhe të stereotipuar, kjo sot dallohet qartë. Por nuk mund të mohohet që refuzimi humanist gjithsesi nuk ishte arbitrar. Nga njëra anë turqit, kur u bënë krye e Islamit në shek. XIV, ishin shumë larg zhvillimit dhe shkëlqimit që kishin zotëruar popujt e Lindjes së Afërme – për shembull arabët e Gadishullit Iberik – dhe as mund të bëhej fjalë për lidhje të tyre me trashëgiminë klasike si në rastin e dijeve arabe. Nga ana tjetër pikërisht në atë kohë humanistët europianë po e rizbulonin, madje duke e përvetësuar, trashëgiminë klasike si frymëzuese të modelit të tyre qytetërimor. Edhe vetë përvoja konkrete e sundimit turk në territoret që turqit pushtonin nuk dëshmonte kurrfarë prirjeje për realizimin e lirisë, tolerancës dhe, në përgjithësi, për kultivimin e atyre vlerave për të cilat humanizmi europian punonte. Tregimet që qarkullonin në Perëndim për doket turke në viset e pushtuara, veçan ato për pushtimin e Kostandinopojës, për trajtimin sa të njerëzve të fesë aq edhe të aristokracisë vendëse, dëshmonin të kundërtën. Arbërit jo vetëm do ta provonin mbi vete këtë situatë, por edhe do ta dëshmonin dikur, sikurse në një varg memorialesh që do të vijonin t'u dërgonin Fuqive të krishtera europiane edhe nga ish-"Mbretëria e Arbërisë".

Në një kontekst të tillë u ngrit figura e Enea Silvios si autori i cili, në kohën e vet, pati një vetëdije më të qartë për Europën: për atë Europë të re politike që rishfaqej në fundin e Mesjetës dhe fillimin e Kohës së Re. Piu II paraqitet si ai që e jetoj më thellësisht këtë situatë dhe e konvertoi atë në objekt të parapëlqyer të jetës së tij dhe të veprës së tij. Me vështrimin e tij kulturhistorik, ende pa u krijuar papë, ai ia kishte njohur edhe botës bizantine europianitetin duke theksuar aspektet e përbashkëta të kulturës europiane qysh në vitet '30 kur kishte punuar me oracione dhe shkrime për bashkimin e Kishës së Lindjes me Kishën e Perëndimit. Deri edhe rënia e Kostandinopojës nën pushtimin turk përbënte për të një hop qenësor, që e detyronte ta përsaktësonte dhe pasuronte edhe më konceptin e ri të Europës. Është fjala, pa ndonjë dyshim, për një koncept kundërshtimor: koncept që luhatej mes mesjetarizmit të trashëguar dhe humanizmit në vlim e sipër. Sepse nuk mund të mos vihet re që, si humanist, Enea Silvio propagandonte një Europë të përfutur si njësi e harmonishme kulturash, ndërsa në praktikë, me veprimet e tij si Kryepriift, vijonte të mbronte idenë e Republica Christiana-s, që do të thoshte të unifikuar mbi idealin e një kryqëzate të llojit mesjetar. Por edhe në këtë kundërshti konceptuale Enea Silvio rezultoi përfaqësues, pothuajse me të tëra karakteristikat, i historiografisë humaniste të lëvizjes së Rilindjes europiane. Në Italinë e kohës së tij, aty ku historiografia laike u shfaq më herët se në vendet e tjera, ajo funksionoi si mjet formimi dhe propagande me interes shtetëror: për të

formuar legjislatorë, diplomatë, ministra, princa, burra shteti. Ky funksion i ri i historiografisë i shtyu humanistët e mëdhenj t'u qaseshin edhe problemeve të kohës me frymën e Polibit, duke e përfillur historinë si disiplinë së cilës nuk i interesonin veçse luftërat dhe politika. Në këtë vështrim shkrimet e humanistëve, ndër to edhe vepra e Enea Silvios, mund të mos kënaqin nga pikëpamja mirëfilli historiografike. Por ato përbëjnë vlera jo të zakonshme si burime informacioni.

Situata origjinale e interesit humanist për popujt e ndryshëm dhe vendet e ndryshme, veçan për personalitet e tyre të spikatura, krijoi kushtet e mbrothëta për përfshirjen dhe përshkrimin edhe të arbërve dhe Arbërisë në veprën e Piut II. Në të mbetën "të sanksionuara", siç do të shihet, edhe marrëdhëniet krejt të veçanta të tij, si humanist ndoshta më shumë se si Kryeprift, me arbërit dhe Arbërinë. Për regjistrimin në këtë dëshmi të arbërve dhe Arbërisë në Europën politike nuk mund t'i zvogëlohet merita, përkundrejt Piut II, partnerit të tij në bregun përkundrejt: prijësit ushtarak dhe politik të arbërve Gjergj Kastrioti. Në formulimin e politikës së tij ai diti, më mirë nga çdo tjetër prijës arbër bashkëkohës i tiji, të peshonte e të vlerësonte interesin e vet dhe të atdheut të vet në marrëdhënie me Kontinentin të cilit Arbëria dhe arbërit i përkisnin. Lidhja e interesit të Arbërisë së tij me pjesën tjetër të Europës rezultoi një konstante e politikës së tij. Se si "pjesa tjetër" e Europës e konceptoi qëndrimin e vet ndaj arbërve dhe Arbërisë së tij – veçan në situatat e luftërave të arbërve të udhëhequr prej tij – kjo mund të lexohet edhe prej dëshmive të një vepre si ajo e Enea Silvios.

Qëndrimi i Europës gjatë periudhës kur thuhej se turqit osmanë e kërcënonin me pushtim, përdhunë dhe skllavërim, – duke ia rrezikuar drejtpërsëdrejti qytetërimin dhe në veçanti gurin e themelit të atij qytetërimi, d.m.th. besimin e krishterë, – paraqitej në përgjithësi problematik. "Princat e krishterë" u dëftuan aq frikacakë, shpirtvegjël, të pafuqishëm e të paaftë për qëndresë sa t'i bishtnonin mbrojtjes së Kontinentit bashkë me qytetërimin e tij. Pati prej tyre që nuk lëvizën as gishtin e këmbës për t'u përfshirë në projektet e mëdha europiane antiturke. Por do të duhej tjetër vend, jo ky libër, për të treguar historinë e degradimit të tyre.

Rëndësi ka që në histori të shënohet se si, mbas rënies nën pushtimin turk të Krujës, Lezhës dhe Drishtit më 1478, të Shkodrës më 1479, të Durrësit më 1501 etj., arbërit do të vijonin të ngulmonin ta bënë jetën, politikën dhe luftën me pjesën tjetër të Europës. Edhe kur, prej fundit të shek. XV, pothuajse e gjithë Europa juglindore binte nën pushtimin turk për t'u bërë pjesë e "Perandorisë osmane", do të vijonte roli i arbërve me prirjen për kryengritje nga njëra anë dhe për rifunksionalizimin e koalicioneve europiane për luftë kundër pushtimit turk, nga tjetra. Šufflay ka pasë dalë në përfundimin se ishin pikërisht "luftërat e Skënderbeut" ato që i dhanë shkas formimit në mbarë Europën të konceptit të një "Arbërie më vete", e cila për të kishte indicie të ketë vijuar deri në shek. XVII. Shekulli XVII është pikërisht kufiri që ka të bëjë me dallimin mes Arbërisë së mirëfilltë dhe të quajturës "Albania Turcica".